



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2020:063985

Datë: 30.08.2024

Numri i dokumentit: 06103079

P.nr.448/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.Sh. nga fshati ... komuna Vushtrri, te cilin e mbron av. Rafet Ferizi, për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327, par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1213/18 të datës 03.07.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqwsor dhe publik, i datës 30.07.2024, pas shpalljes së aktgjykimit, më datë 30.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: A.Sh. nga i ati A... e nëna N..., e vajzërisë H..., i lindur më ... në fshatin ... ku edhe jeton, komuna e Vushtrrisë, me nr. personal ..., di shkrim lexim, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datë më 07.05.2015, rreth orës 00:35 në Vushtrri, në rr. "...", pas marrëveshjes paraprake kanë ardhur me automjetin "Golf 4" me ngjyrë hiri, me targa ... para lokalit ..., me qëllim që vetit ti sigurojnë dobi të kundërligjshme pasurore, i pandehuri i parë A... me bërryl të dorës e thyen xhamin në lokalit e cekur (vitrinë), i pandehuri i dytë A... pret në automjetin e parkuar e i pandehuri i tretë B.M. bën roje me qëllim që të hyjnë në lokalit e cekur dhe nga i njëjti të marrin mallin, por në këtë qëllim janë penguar pasi që janë vërejtur nga ana e G. M. — pronarit të lokalit të cekur,

- Me këtë në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 4, 7, 17, 21, 28, 31, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 76 dhe nenit 327 par.1 të KPRK-së dhe neneve 248, 365, 450 dhe 463 të KPPK-së, shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Me te cilin i pandehuri dënohet me gjobë në shumë prej gjashtëqind euro (600€), te cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh. Ne qofte se i pandehuri nuk mund apo nuk donë ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur 20 € gjobë për një dite burgim, dhe kumulativisht,

## DËNIM ME KUSHT

Me te cilin te pandehurit i vërtetohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej një viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në periudhën verifikuese prej dy vitesh nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumë prej tridhjetë euro (30€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumë prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1213/18 të datës 03.07.2019, kundër të pandehurve A.V., A.Sh. dhe B.M., për shkak të veprave penale Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 327, par.1 lidhur me nenin 28, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar disa seanca të shqyrtimit fillestar, por që për shkak të mungesës së të pandehurve seancat janë shtyrë, andaj gjykata ka lëshuar urdhër arrest për të pandehurit A.V. dhe B.M. dhe ka veçuar procedurën penale ndaj tyre. Duke qenë se gjykata ka siguruar vetëm prezencën e të pandehurit A.Sh., gjykata ka zhvilluar procedurën penale vetëm ndaj këtij të pandehuri.

### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me fajësinë*

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më datën 07.08.2023, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, por që pas konsultimeve me mbrojtësin e tij i pandehuri A.Sh. ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë.

Me dt. 01.09.2024, mbrojtësi i te pandehuri A.Sh. ka paraqitur kërkesën për hudhje të aktakuzës, e cila kërkesë me aktvendimin e kësaj gjykate dt. 30.10.2023, është refuzuar.

Pasi janë krijuar kushtet ligjore me dt. 30.07.2024, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale ku të pandehurit në vështirësi të dispozitave të nenit 322 të KPP-së i është dhënë mundësia që të deklarohej lidhur me fajësinë, ku i pandehuri pas konsultimeve me avokatin mbrojtës ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës dhe ka shtuar se ky rast ka ndodhur bukur moti, aq sa edhe i ka harruar detajet e këtij rasti, por që gjithsesi i vije keq për atë që ka ndodhur dhe është penduar, i është kthyer jetës normale, ka krijuar familje, punon punë të ndershme dhe i ndihmon familjes, në të ardhmen kurrë nuk pret që të merret me kësë veprime, pasi që do ta respektoj ligjin dhe të jetë i dobishëm për familjen.

#### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se vlerëson se deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë sipas aktakuzës është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij, andaj një pranim i tillë është bërë konform dispozitave të nenit 322 të KPPK-së lidhur me pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i te pandehurit av. Rafet Ferizi, lidhur me pranimin e fajësisë të te pandehurit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga ana e të mbrojturit është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin, gjykatës i ka propozuar që kjo të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit nga ana e gjykatës.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti policor dt. 07.05.2015; Raporti i oficerit i dt.07.05.2015, Procesverbali i marrjes në pyetje të te dëmtuarit G.M. dt. 07.05.2015; Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarit A.V. i datës 07.05.2015; Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarit A.Sh. i datës 07.05.2015; Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarit B.M. i datës 07.05.2015; Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit B.A. i datës 07.05.2015; Vertetimi mbi konfiskimin e sendeve dt. 07.05.2015; Foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se pas aprovimit të fajësisë nga ana e gjykatës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të kësaj aktakuze, andaj prokurori i shtetit i propozon gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit, si dhe ta obligojë në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore. Ndërsa, gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim gjyqësor, ndërsa si rrethana rënduese ta marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë

penale, po ashtu gjykatës i ka propozuar që zyrtarisht të pajiset me certifikatën e evidencës penale, dhe varësisht se çka rezulton nga ajo, se i pandehuri a është i dënuar më parë ose jo, nëse është i dënuar të merret si rrethanë rënduese, ndërsa nëse nuk është i dënuar më parë, të merret si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i te pandehuri ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se marrë parasysh faktin se në kohën kur është kryer vepra penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, i mbrojturi im ka qenë i pa punë i shoqëruar me shoqëri të keqe, pa qenë i vetëdijshëm në rastin konkret është gjendur në një situatë që nuk e ka ditur as vetë se çka po bëhet dhe për çfarë po shkojnë, por pas veprimit e ka kuptuar se ka bërë një vepër penale të vjedhjes. I mbrojturi im ka 8 vite që është në botën e jashtme në Gjermani, dhe tani është një person krejt tjetër, që i ndihmon familjes dhe të afërmve të tij. Pendimi i tij i thellë e bën të besueshëm faktin se i njëjti asnjëherë nuk do të merret me vepra penale të kësaj natyre apo veprime të tjera të kundërligjshme, e aq më pak me vepra të kësaj natyre, po ashtu përgjigja në çdo rast e ftuar nga angazhimi im si avokat nga Gjermania, (duke aluduar ne faktin se i pandehuri i ishte përgjigjur thirrjes se gjykatës pasi ishte njoftuar nga mbrojtësi i tij dhe kishte udhëtuar për tu paraqitur ne gjykatë), është dëshmi e qartë se A... që nga fillimi ka dashur që të bashkëpunojë me gjykatën, andaj gjatë shqiptimit të sanksionit penal të merren parasysh këto rrethana lehtësuese, ashtu siç e parasheh Kodi Penal pranimin e fajësisë.

I pandehuri, ne fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se pajtohet me deklaratimet e avokatit dhe ka shtuar se është shumë i penduar, ndihet shumë keq dhe i premtun gjykatës se raste të tilla më nuk do të ndodhin kurrë.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327, par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 e 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 327, par.1 të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Vjedhja e rëndë e kryen “1. Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse: 1.1. vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme; 1.2. kryesi ka vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme apo të vrazhdë; 1.3. kryesi ka shfrytëzuar gjendjen e krijuar si rezultat i zjarrit, vërshimit, tërmetit apo fatkeqësive të tjera; ose 1.4. kryesi ka shfrytëzuar paaftësinë ose gjendjen tjetër të rëndë të personit tjetër.”, ndërsa neni 31 i KPRK-së përcakton se “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.” E po ashtu neni 28 i KPRK-së përcakton se “1. Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale. 2. Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose

*më shumë vjet burgim dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë tjetër veprë penale dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj. 3. Personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet.”*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 327, par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, në rastin konkret dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri në shqyrtim gjyqësor, pendimin e të pandehurit për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale të kësaj apo natyrës tjetër, moshën e tij të re në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe faktin se i pandehuri në atë kohë ishte i gjendjes së dobët ekonomike. Ne vështrim të dispozitave të nenit 28 të KPRK-së për veprën penale që është filluar kryerja e veprës penale, por nuk ka përfunduar, pra nuk janë përfunduar veprat penale, ashtu që të njëjtat kanë mbetur në tentativë, dënimi mund të zbutet e rrjedhimisht gjykata e ka zbutur dënimin për veprën e mbetur në tentativë.

Gjykata duke vlerësuar si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor, e po ashtu duke konsideruar faktin se vepra ka mbetur në tentativë, e që sipas vetë dispozitës së nenit 28 të KPRK-së, parashihet se mund të zbutet dënimi për veprat e mbetura në tentativë, gjykata ka aplikuar dispozitën e nenit 75 par.1, pika 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë ose në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë” e lidhur me nenin 76 par.1 pika 1.3 të KPRK – së, ku është përcaktuar se “nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) viti, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”.

Po ashtu gjykata, pas aplikimit të dispozitave të mësipërme, me rastin e shqiptimit të dënimit ka aplikuar edhe nenin 50, 51 e 52 par 2, të KPRK-së, ku parashihet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”.

Ashtu që, sipas bindjes së gjykatës, dënimi i kushtëzuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në periudhën verifikuese prej dy vitesh, si dhe dënimi me gjobë në shumën prej gjashtëqind euro (600€), i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej

15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës*

Vendimin lidhur me udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil.”*

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 par.1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.448/20, datë 30.08.2024

Zyrtarja ligjore  
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Ferki Xhaferi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.